

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-106/15**

**Prishtinë,  
18 tetor 2017**

Në çështjen juridike të:

**D. R**

Përfaqësuar nga:

**V. J.**  
Rruga “25 Maji 1A”  
18000 Nish  
Republika e Serbisë

**Pala ankuese**

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit, Anna Bednarek dhe Shukri Sylejmani, Gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/247/2014 (lënda e regjistruar në AKP me numër KPA47349), të datës 18 qershor 2014, pas shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 18 tetor 2017, mori këtë:

## AKTGJYKIM

1. Ankesa e V. J. e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/247/2014 të datës 18 qershor 2014, lidhur me kërkesën e regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronës me numër KPA47349, refuzohet si e pabazuar.
2. Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/247/2014 i datës 18 qershor 2014, sa i përket kërkesës së regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronës me numër KPA47349, vërtetohet.

### Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 5 dhjetor 2007, D. B. R. e përfaqësuar nga vajza e saj V. J. (tani e tutje: pala ankuese) ka paraqitur kërkesë pranë Agjencisë Kosovare të Pronës (tani e tutje “AKP”), duke kërkuar vërtetimin e së drejtës pronësore dhe ri-posedimin e banesës me sipërfaqe prej 25 m<sup>2</sup>, e cila gjendet në rrugën “Rade Popovic”, P+6+pk, hyrja nr. I, kati VI, nr. 45, në Komunën e Gjilanit (tani e tutje: prona e kërkuar). Sipas palës ankuese humbja e posedimit ka ndodhur më 12 qershor 1996 për shkak të rrethanave që lidhen me konfliktin në Kosovë i cili ka ndodhur në mes të viteve 1998 dhe 1999.
2. Në mbështetje të kërkesës së saj, pala ankuese i ka dorëzuar AKP-së këto dokumente:
  - Kopjen e vendimit nr. 1768/11 të lëshuar nga Bordi i ndërmarrjes shoqërore “Morava e Binçës” më 17 maj 1998 në bazë të së cilit kërkesa e punëtores D. R. është aprovuar dhe palës ankuese i është ndarë prona e kërkuar “në shfrytëzim, me të gjitha të drejtat nga ligji për banim, përfshirë të drejtën për blerjen e banesës së lartpërmendur”;
  - Kopjen e vendimit nr. 1768/12, mbi ndarjen e banesës, të lëshuar nga ndërmarrja shoqërore “Morava e Binçës” më 18 maj 1998, sipas të cilit D. R. i është ndarë prona e kërkuar për shfrytëzim, në bazë të dispozitave të ligjit për banim;
  - Kopjen e faturës të datës 17 maj 1998 në të cilën figuron se D. R. e ka paguar shumën prej 22.616 Dinarë për blerjen e pronës së kërkuar;
  - Kopjen e kontratës së shitblerjes së banesës në pronë shoqërore të lidhur më 19 maj 1998 në mes të ndërmarrjes shoqërore “Morava e Binçës” nga Gjilani si shitëse dhe D.R. si blerëse e pronës së kërkuar. Nënshkrimet e palëve kontraktuese janë vërtetuar më 19 mars 1999 pranë Gjykatës Komunale të Gjilanit me numër të referencës 38/99;
  - Kopjen e autorizimit të vërtetuar pranë Gjykatës Komunale të Nishit të datës 30 maj 2014, me numër të referencës 6557/2014, përmes së cilit D. R. e autorizon vajzën e saj V.J. që ta përfaqësojë pranë AKP-së dhe të gjitha institucioneve tjera kompetente lidhur me pronën e kërkuar.
3. Më 25 janar 2008, AKP-ja e ka bërë njoftimin e pronës. Prona e kërkuar ka rezultuar të jetë e zënë nga M. A, i cili nuk ka pretenduar të drejta pronësore mbi pronën e kërkuar.
4. Pasi që askush nuk ka paraqitur përgjigje ndaj kërkesës brenda afatit ligjor prej 30 ditësh në përputhje me nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 siç është ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 mbi ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale (tani e tutje “Ligji nr. 03/L-079”), kërkesa është konsideruar jokontestuese.
5. Sipas raporteve të verifikimit të Sekretariatit Ekzekutiv të AKP-së, vendimi mbi ndarjen e banesës nr. 1768/12 nuk është gjetur as tek institucionet kompetente të Kosovës, as tek ato të zhvendosura në Serbi. Lidhur me kontratën e shitblerjes së banesës në pronë shoqërore nr. 38/99, referenti i Gjykatës Komunale të Gjilanit ka theksuar se kontrata në fjalë është falsifikuar, pasi që personi i cili i ka vërtetuar nënshkrimet e palëve kontraktuese ka qenë sekretarësh personale e Kryetarit të Gjykatës dhe jo referenti i cili është i autorizuar që ta bëjë vërtetimin e nënshkrimeve. Referent në atë kohë ka qenë Z. M. P. Prandaj, kontrata është verifikuar negativisht nga AKP-ja.

6. Me vendimin e saj KPCC/D/A/247/2014 të datës 18 qershor 2014, Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (tani e tutje “KKPK”) ka refuzuar kërkesën. Në arsyetimin e tij, Komisioni ka sqaruar se dokumentet të cilat i ka dorëzuar paraqitësja e kërkesës nuk janë verifikuar si të vërteta nga Sekretariati Ekzekutiv. Për më tepër, Komisioni ka përfunduar se në mungesë të ndonjë prove tjetër vërtetuese, thjeshtë vetëm faturat e shërbimeve komunale nuk ishin të mjaftueshme për të provua të drejtën pronësore të pretenduar. Rrjedhimisht, e ka refuzuar kërkesën, pasi që paraqitësja e kërkesës ka dështuar që ta vërtetojë të drejtën pronësore apo ndonjë të drejtë tjetër mbi pronën e kërkuar.
7. Më 7 tetor 2014, palës ankuese i është dorëzuar vendimi, dhe më 30 tetor 2014 ajo ka paraqitur ankesë pranë Gjykatës Supreme.

### **Pretendimet e palës ankuese**

8. Pala ankuese pretendon se vendimi i KKPK-së përmban gabime fundamentale dhe shkelje të rënda të ligjit material dhe mbështetet në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të fakteve. Ai ka kundërshtuar deklaratën e Komisionit lidhur me pamundësinë për t’i verifikuar dokumentet e paraqitura nga ajo. Ajo ka insistuar se janë paraqitur vetëm kopjet e certifikuara të dokumenteve, të cilat sipas palës ankuese kanë qenë të vlefshme dhe nuk ka pasur asnjë indikacion se ato nuk janë origjinale. Më tutje, pala ankuese ka theksuar se përfundimi i Komisionit se ajo nuk ka paraqitur asnjë provë tjetër për vërtetimin e së drejtës mbi pronën e kërkuar nuk ishte i vërtetë, pasi që ajo ka paraqitur në shkresë nga Telekomit i Serbisë e cila konfirmon se ajo ka qenë parapaguese e linjës telefonike në Gjilan në adresën e pronës së kërkuar.
9. D. R. ka kërkuar nga Gjykata Supreme që t’ia aprovoj ankesën dhe t’ia vërtetojë të drejtat pronësore mbi pronën e kërkuar.

### **Arsyetimi ligjor**

10. KKPK-ja e ka bazuar vendimin e tij në përfundimin se pala ankuese ka dështuar që të paraqes ndonjë provë e cila do të mund të verifikohet nga AKP-ja në përputhje me të drejtën pronësore të palës ankuese mbi pronën e kërkuar. Sekretariati Ekzekutiv as sipas detyrës zyrtare nuk ka mundur ta sigurojë një provë të tillë. Në vend të kësaj, pala ankuese ka pretenduar se ka dorëzuar kopje të certifikuara të vendimit mbi ndarjen e banesës nr. 1768/12, si dhe kontratën e shitblerjes së banesës në pronë shoqërore nr. 39/99 – të dyja të vlefshme dhe origjinale. Sidoqoftë, ato dokumente janë verifikuar negativisht nga Sekretariati Ekzekutiv i AKP-së, pasi që ato nuk janë gjetur as tek institucioneve kompetente të Kosovë e as të autoritetet e zhvendosura në Republikën e Serbisë, gjithashtu ka pasur dyshime lidhur me vërtetimin e nënshkrimeve në fund të kontratës.
11. Gjykata Supreme ka shqyrtuar parashtrirat që gjenden në shkresat e lëndës, vendimin e kundërshtuar dhe pretendimet e ankesës në përputhje me nenin 194 të Ligjit mbi procedurën kontestimore nr. 03/L-006 (tani e tutje “LPK”) dhe ka gjetur se ankesa është e pabazuar.
12. Në përputhje me nenin 3.1 të Ligjit 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në një urdhër nga KKPK-ja për ri-posedimin e pronës nëse paraqitësi i kërkesës “dëshmon” të drejtën pronësore ose të drejtën e shfrytëzimit të pronës private, përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale dhe gjithashtu dëshmon se ai/ajo nuk është në gjendje ta ushtojë të drejtën e tillë pronësore për shkak të rrethanave të lidhura drejtpërsëdrejti me ose që rezultojnë nga konflikti i armatosur i cili ka ndodhur në Kosovë në mes të 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. Sipas kësaj dispozite ligjore, pala ankuese është dashur të paraqes prova për t’i vërtetuar pretendimet e saj për të drejtën pronësore, ose të drejtën e shfrytëzimit të pronës së kërkuar.

13. Pala në procedurën pranë AKP-së dhe Gjykatës Supreme është e obliguar që ta dëshmojë të drejtën e saj pronësore për të kërkuar ri-posedimin e pronës së kërkuar. Dokumentet të cilat i dorëzon verifikohen nga Sekretariati Ekzekutiv i AKP-së. Përfundimi se dokumentet e paraqitura nga pala nuk mund të verifikohen pozitivisht, duhet të shpie në refuzimi në kërkesës, si në këtë lëndë. Fakti se nuk ka mundur të vërtetohet përtej çdo dyshimi se vendimi dhe kontrata kanë qenë të vërteta, nuk mund të rezultojë në aprovimin e kërkesës. Për më tepër, faturat e pagesës për shërbime të caktuara të ofruara në pronën e kërkuar nuk mund t'i zëvendësojnë provat të cilat vërtetojnë pronësinë mbi pronën e kërkuar.
14. Për këto arsye, Gjykata Supreme gjen se KKPK-ja ka lëshuar vendim të drejtë në bazë të procedurës së plotë dhe korrekte. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme gjen se nuk ka pasur asnjë shkelje të ligjit material apo vërtetim jo të plotë të fakteve.
15. Duke pasur parasysh atë që u tha më lart, në përputhje me nenin 13.3 (c) të Ligjit nr. 03/L-079, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **Këshillë juridike**

Në pajtim me nenin 13.6 të Ligjit nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

**Beshir Islami, Kryetar i Kolegji**

**Anna Bednarek, Gjyqtare e EULEX-it**

**Shukri Sylejmani, Gjyqtar**

**Bjorn Olof Brautigaam, Ushtrues Detyre i Referentit të EULEX-it**